



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2021 mori këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E MONUMENTIT "NEVER SAY NEVER"

- I. **MIRATOHET** Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e monumentit "Never Say Never".
- II. Lokacioni për vendosjen e këtij monumenti, është propozuar të jetë në hapsirën brenda sheshit "Adem Demaçi", përkatësisht në parcelën kadastrale, nr. 7580-1, ZK Prishtinë, në pronësi - pronë shoqërore, KK Prishtinë.
- III. Ky vendim paraqet bazë për caktimin e lokacionit të këtij monumenti.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ortofoto e lokacionit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtoria e Kulturës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-185163/21, më 03.09.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



ARSYETIM

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e monumentit “Never Say Never”

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën, nr. 04-353/01-174948/21, dt. 24.08.2021, e Drejtorisë së Kulturës të Komunës së Prishtinës, për vendosjen e monumentit “Never Say Never” në kuadër të aktivitetit “Art në hapësira publike”, në sheshin “Adem Demaçi”.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, sipas kërkesës së lartëcekur nga Drejtoria e Kulturës, ka identifikuar lokacionin për vendosjen e monumentit, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban, i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01. nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë për hapësirë me përmbajtje publike. Lokacioni i propozuar shtrihet në parcelën kadastrale, nr. 7580-1, ZK Prishtinë, në pronësi - pronë shoqërore, KK Prishtinë.


Monumenti në fjalë është propozuar të vendoset në hapësirën brenda këtij sheshi sipas propozimit të bashkëngjitur, andaj në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit, sipas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës të Komunës së Prishtinës.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset memoriali është sipërfaqe e gjelbëruar, meqë kjo zonë më herët ka shërbyer edhe si “Parku i të martuarve”, andaj gjatë vendosjes së monumentit duhet t’i kushtohet kujdes i veçantë ambientit, drurëve, dhe propozohet që monumenti të vendoset në madhësi, formë dhe material të përcaktuar sipas kërkesës së parashtruar, duke përcaktuar saktë dimensionin e bazamentit të monumentit, si dhe verifikimin paraprak në terren, në mënyrë që të mos ketë ndonjë pengesë.

Bashkëngjitur:

Ortofoto e lokacionit, sipas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës.

Lokacioni i propozuar nga Drejtoria e Kulturës për vendosjen e shtatores;



Skica e lokacionit sipas Drejtorisë së Kulturës

Vizatimet teknike

